

## Fletë informuese për anketimin e prindërve në kuadrin e vlerësimit të jashtëm të shkollës

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Me detyrë të departamentit të arsimit, dhe të kulturës çdo shkollë në kantonin Solothurn vlerësohet një herë në rreth pesë vjet. Me vlerësimin e jashtëm të shkollë kontrollohet nëse shkollat përmbushin kërkesat elementare dhe shkollat marrin një informate kthyesë në lidhje me nivelin e tyre të zhvillimit.

Skuadra e vlerësimit anketon prindërit **me shkrim me anën e një pyetësori ose me gojë në intervista në grup:**

### a) Anketimi me shkrim i prindërve (pyetësori)

- Ju lutemi plotësojeni pyetësorin nëse është e mundur **online**. Një gjë e tillë lehtëson vlerësimin anonim dhe efikas. Nëse nuk e dëshironi një gjë të tillë ose nuk mundeni ju lutemi përdorni **pyetësorin në letër**.
- Nëse keni disa fëmijë, ju mund të plotësoni – për sa kohë ju dëshironi – për çdo fëmijë nga një pyetësor.

<b>Anketimi online (për kompjuter, tablet dhe Smartphone)</b>	<b>Anketimi me letër</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketimi mund të kryhet në <b>12 gjuhë</b>.</li> <li>• Vizitoni <b>adresën e internetit</b> të dhënë në pyetësorin në letër dhe jepni në fushën „TAN/Fjalëkalimi“ <b>kodin tuaj të hyrjes</b>.</li> <li>• <b>Përgjigjuni pyetjeve</b> dhe përfundojeni pyetësorin me „<b>Dërgo</b>“.</li> <li>• Hidheni pyetësorin në letër.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ju lutemi përdorni për plotësimin e pyetësorit një stilolaps <b>të errët dhe me majë të hollë</b>.</li> <li>• Ne ju lutemi që pyetësorin e plotësuar t'ia jepni vajzës tuaj/djalit tuaj jo të palosur në një zarf të mbyllur për ta sjellë në shkollë.</li> <li>• Personeli mësimor do ti grumbullojë zarfat dhe do t'ia dorëzojë të pahapura skuadrës së vlerësimit.</li> </ul>

### b) Anketimi me gojë i prindërve (intervista e prindërve në grupe)

Si plotësim për anketimin me anën e pyetësorëve zhvillohen intervista me gojë të prindërve. Këto shërbejnë për pyetur më thellë mendimin e prindërve dhe për të kuptuar më mirë rezultatet e anketimin me shkrim. Prandaj është e rëndësishme që sa më shumë prindër të jenë në dispozicion për një intervistë. Për këtë ne do t'ju lutëshim të regjistroheshit me anën e formularit të regjistrimit që ndodhet bashkëlidhur për një nga intervistat e grupeve.

Ne ju falënderojmë shumë për bashkëpunimin tuaj.

Sinqerisht

Qendra e Specializuar për Vlerësimin e Jashtëm të Shkollave PH FHNW